


BULETINI

Buletini nr.18, Viti XIV, 2021



**Fillon operimi i KOSTT si Zonë Rregulluese në kuadër
të Bllokut Rregullues Shqipëri-Kosovë**

Funksionalizohet linja interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri

Themelohet Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX

PËRMBAJTJA

● Fillon operimi i KOSTT si Zonë Rregulluese në kuadër të Bllokut Rregullues Shqipëri-Kosovë	3
● Funksionalizohet linja interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri	4
● Themelohet Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX	5
● U mbajt mbledhja konstitutive e përbërjes së re të Bordit të Drejtoreve të KOSTT	6
● Mustafë Hasani merr detyrën e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT	7
● Realizohet vizitë pune në Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Republikës së Shqipërisë (OST), në Tiranë	7
● Komuna e Rahovecit, Malishevës dhe Therandës me furnizim më të besueshmërës dhe cilësor me energji elektrike, ndërkaq Rrjeti i Transmetimit të Kosovës plotëson kriterin e sigurisë së furnizimit N-1	8
● KOSTT i bashkohet kampanjës globale #OrangeTheWorld	9
● Në 14 vjetorin e themelimit, KOSTT prezanton të arriturat kryesore	10
● KOSTT dhe MEPSO (Maqedoni e Veriut) krijojnë kushte për tregtim të drejtpërdrejtë të energjisë elektrike në mes të dy vendeve	11
● Nënshkruhet Marrëveshja e re e Kyçjes KOSTT/ENTSO-E	12
● Me rastin e katërmëbëdhjetë vjetorit të themelimit, KOSTT ndau mirënjojje për punëtorët e dalluar	13
● Miratohet raporti vjetor financiar i KOSTT nga Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Transfere	14
● Nënshkruhet kontrata në mes të KOSTT dhe Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) për shërbimet e Rezervës Manuale për Restaurimin e Frekuencës, për rregullimin zbritës	14
● KOSTT i bashkohet UNICEF Kosova dhe Kosovo CSR Network në kampanjën #united4children dhe #back2school	15
● Nënshkruhen Marrëveshjet për Kyçje në Sistemin e Transmetimit të Kosovës të kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme të energjisë	15
● Kryeministri i Republikës së Kosovës priti në takim Bordin e KOSTT	16
● KOSTT dhe KEDS nënshkruan Marrëveshjet e Kyçjes për nënstacionet e reja, NS 220/10(20) kV Malisheva dhe NS 110/10(20) kV Ferizaj 3	16
● KOSTT merr pjesë në punëtorinë me temën “Dekarbonizimi i Energjisë në Kosovë”	17
● Ambasadori i RF Gjermane z. Rohde vizitoi KOSTT-in	17
● KOSTT nënshkruan memorandum mirëkuptimi me Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të Universitetit Hasan Prishtina	18
● Agjencia për Barazi Gjinore pranë Zyrës së Kryeministrit njoftohet me të arriturat dhe planet e KOSTT në fushën e barazisë gjinore	18
● KOSTT dhe KEDS/KESCO bashkërendojnë përgatitjet teknike për fillimin e operimit të pavarur të KOSTT si Zonë Rregulluese brenda Bllokut AK	19
● Mbahet Asambleja e Përgjithshme e Bursës Shqiptare të Energjisë ALPEX	19
● Përfaqësues të Kontigjentit të Britanisë së Madhe të KFOR vizituan KOSTT	20
● KOSTT i bashkohet partneritetit global për fuqizimin e të rinjve “Generation Unlimited”	20
● Ambasadori i Norvegjisë z. Grøndahl vizitoi KOSTT-in	21
● Nënshkruhet Marrëveshja për Procesin e Shkëmbimit të të Dhënavës për Barazim Përfundimtar të Energjisë së Shkëmbyer ndërmjet dy zonave rregulluese OST dhe KOSTT	21
● Nënshkruhet kontrata në mes të KOSTT dhe Korporatës Elektroenergetike Shqiptare (KESH) për shërbimet e Rezervës Manuale për Restaurimin e Frekuencës	22
● Nënshkruhen Marrëveshjet për Kyçje në Sistemin e Transmetimit të Kosovës të kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme të energjisë	23
● Ekipi i KFOR për Monitorim dhe Ndërlidhje vizitoi KOSTT	23
● KOSTT përmbyll vitin 2020 me suksese historike për kompaninë dhe gjithë sektorin e energjisë së Republikës së Kosovës	24
● Me realizimin adekuat të Planit vjetor të Mirëmbajtjes u sigura shkallë e lartë e disponueshmërisë dhe besueshmërisë së Rrjetit të Transmetimit të Kosovës	25
● Koordinimi dhe bashkëpunimi në mes të institucioneve, thelbësore për funksionimin dhe përparimin e sektorit të energjisë	26
● Vlerësohet i suksesshëm operimi i Bllokut Rregullues të Sistemeve Energjetike Kosovë-Shqipëri (Blloku AK)	27
● Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT priti në takim Dekanin e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të Universitetit “Hasan Prishtina”	28
● Kontributi në mirëqenien e komunitetit, përkushtim i vazhdueshëm i KOSTT sh.a	28
● #NeJemiKOSTT	29

Fillon operimi i KOSTT si Zonë Rregulluese në kuadër të Bllokut Rregullues Shqipëri-Kosovë

Me rastin e fillimit të operimit të KOSTT si zonë rregulluese në kuadër të Bllokut rregullues Shqipëri-Kosovë, në ambientet e ndërtesës qendrore të KOSTT, menaxhmenti në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z.Mustafë Hasani si dhe Bordi i KOSTT në krye me Kryesuesin z.Jeton Mehmeti pritën në takim Kryeministrin e Kosovës z.Abdullah Hoti dhe Ministrin e Ekonomisë dhe Ambientit z.Blerim Kuçi, me bashkëpunëtorë.



Me këtë rast, delegacioni i lartë i Qeverisë së Republikës së Kosovës u njoftuan për së afërm me përgatitjet profesionale që janë realizuar nga ana e KOSTT për fillimin e implementimit të Marrëveshjes së re për Kyçje KOSTT/ENTSO-E që kanë mundësuar që sot KOSTT përfundimisht të filloj të operoj me të gjitha të drejtat e barabarta me homologët e tjerë ndërkombëtar, sipas standardeve evropiane për operim.

Me fillimin e operimit të KOSTT si Zonë rregulluese në kuadër të Bllokut rregullues AK, KOSTT do të menaxhoj kapacitetet interkonektive të Kosovës me Operatorët e Sistemeve Transmetuese fqinje. Me këtë, gjithashtu bëhet funksionalizimi i linjës interkonektive të tensionit të lartë 400kV Kosovë-Shqipëri i cili do të ndikoj në rritjen e shkëmbimeve të energjisë elektrike ndërmjet dy sistemeve, rritjen e kapaciteteve transmetuese, si dhe ngritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së sistemeve elektroenergetike të Kosovës dhe Shqipërisë dhe regjionit. Kjo do t'i hap rrugën zhvillimit të mëtejmë të tregut të përbashkët përmes bursës së energjisë ALPEX e cila është themeluar së voni.

Kryeministri i Kosovës z.Abdullah Hoti përgëzoi KOSTT-in për këtë të arritur dhe theksoi se "Mbështetja e



Qeverisë për sektorin e energjisë do të jetë maksimal, ngaqë stabiliteti energetik është parakusht për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit, rritje të investimeve të brendshme dhe të atyre të jashtme, si dhe në funksion të mirëqenies së qytetarëve."

Me këtë rast KOSTT merr përgjegjësi të shtuar për të kontribuar në rritjen e sigurisë së operimit sistemit regional të energjisë elektrike, si detyrë primare e Operatorëve të Sistemit të Transmisionit.

Delegacioni qeveritar gjithashtu vizituan edhe Qendrën Nacionale Dispeçerike në KOSTT prej nga u njoftuan rreth operimit në kohë reale të Sistemit të Transmetimit së Republikës së Kosovës.



KOSTT falënderon të gjitha institucionet shtetërore dhe institucionet ndërkombëtare si SHBA dhe BE për mbështetjen e vazdueshme në jetësimin e Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT/ENTSO-E dhe në veçanti vlerësohet partneriteti me ShBA dhe RF të Gjermanisë në këtë process. Gjithashtu, falënderim i veçantë për ENTSO-E, Operatorët e Sistemeve Transmetuese të Evropës Kontinentale e në veçanti OST Shqipëri dhe Swissgrid si dhe grupin teknik PG KOSTT dhe ekipet profesionale të KOSTT për përbashkëtjen e obligimeve teknike ndaj kërkësave të ENTSO-E.

Funksionalizohet linja interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri

Pas më shumë se katër vite që nga përfundimi i ndërtimit të linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri në të dy anët e kufirit, me 14 Dhjetor 2020 përfundimisht linja e njohur si "Autostrada Energjetike Kosovë-Shqipëri" komercialisht është vënë në funksion.



Kjo vie si rezultat i fillimit të operimit të KOSTT si Zonë rregulluese në kuadër të Bllokut rregullues Shqipëri-Kosovë.



Venia në operim e linjës interkonektive të tensionit të lartë 400kV Kosovë-Shqipëri do të ketë impakt pozitiv në optimizimin e dy sistemeve, rritjen e kapaciteteve transmetuese, rritjen e sigurisë dhe beseshmërisë së sistemeve elektroenergetike të Kosovës, Shqipërisë dhe regjionit si dhe do të ndikojë në zhvillimin e tregut të të dy vendeve si dhe tregut rajonal të energjisë elektrike.

Në një video lidhje direkte e cila u realizua me Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë, Kryesuesi i Bordit të KOSTT z.Jeton Mehmeti dhe zv.Kryeshefi i KOSTT z.Kadri Kadriu shprehën falënderimin e tyre të veçantë përbashkëpunimin e vazhdueshëm profesional nga ana e menaxhmentit



të OST Shqipëri me ç'rast u theksua që angazhimi shumë vjeçar i dy operatorëve KOSTT dhe OST është kurorëzuar me operacionalizimin e Bllokut AK, linjës interkonektive 400kV Kosovë-Shqipëri si dhe projekteve tjera të përbashkëta në zhvillim siç është bursa e energjisë ALPEx.

Ky investim në vlerë të përgjithshme prej 33.5 milion Euro për pjesën e Kosovës, nga e cila €16.5 milion grant + €17 milion kredi u financua nga Qeveria Gjermane nëpërmes Bankës Gjermane për Zhvillim-KfW. Ngashëm, Qeveria Gjermane nëpërmjet KfW gjithashtu ka financuar pjesën e linjës në anën e Republikës së Shqipërisë.



Në video lidhjen direkte e cila u realizua me KOSTT përveç menaxhmentit të OST, prezent ishin edhe Kryeministri i Shqipërisë z.Edi Rama dhe Ministria e Energjetikës e Shqipërisë znj.Belinda Balluku.

Themelohet Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX

Me 5 tetor 2020 në Prishtinë, KOSTT dhe OST Shqipëri themeluan Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX. Marrëveshja e Aksionarëve për themelimin e ALPEX si dhe Statuti i saj, u nënshkruan në Prishtinë nga Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT-it z. Ilir M.Shala dhe Administratori i Operatorit të Sistemit të Transmetimit Shqiptar(OST) z.Skerdi Drenova.



Themelimi i Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) shënon një standard të ri të operimit në sektorin e energjisë, i cili do të garantojë më shumë transparencë dhe konkurrencë në tregun e energjisë elektrike si dhe do të ndikojë në rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike, shfrytëzimin më efikas të kapaciteteve ndërkufitare si dhe pritet që çmimi i energjisë elektrike do të ulet për qytetarët e të dyja vendeve.

Me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Aksionarëve, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Ilir M.Shala theksoi: "Në vazhdimësi të bashkëpunimit në mes të KOSTT dhe OST, ne sot po e konkretizojmë edhe një bashkëpunim të radhës. Kjo është një ditë tjeter historike për ne dhe është hap tjeter drejt integrimit të mëtutjeshëm në tregun e integruar evropian të energjisë elektrike, ku ne po synojmë të arrijmë. Përgëzoj grupet punuese të KOSTT dhe OST, përfaqësuesit e ministrite përkatëse, ZRRE dhe ERE përpunën ekipore dhe profesionale të bërë ndër vite si dhe falënderoj përzemërsisht

Ambasadën Amerikane, USAID, Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë (Vjenë) dhe miqtë tjerë për përkrahjen e dhënë."

Ndërsa Administratori i OST Shqipëri z. Skerdi Drenova theksoi se Bursa Shqiptare e Energjisë do t'i hapë rrugë perspektivës për tregimin e energjisë në të dy vendet me çmime të parregulluara duke krijuar mundësi të mëdha në përfitime ekonomike të prodhuesve dhe përdoruesve të energjisë elektrike.

Themelimi i Bursës Shqiptare të Energjisë është në përputhje me politikat e Qeverisë së Shqipërisë dhe Kosovës përliberalizim të tregut të energjisë si dhe një nga objektivat e pakos së tretë të direktivave të Bashkimit Evropian për themelimin e Tregut të Brendshëm Evropian të Energjisë Elektrike ("IEM") si dhe të vendimeve të arritura në kuadër të Procesit të Berlinit përkatësisht Samitin e Ballkanit Perëndimor në Vjenë për themelimin e operatorit (bursës) për operimin dhe rrjedhimisht bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike një Dité Para (DAM) dhe Brenda ditës (IDM), në një treg rajonal.



Përveç tjerash ALPEX do të inkurajojë investime të reja në gjenerimin e energjisë elektrike dhe në rrjetet e transmetimit në Kosovë dhe Shqipëri, si dhe shfrytëzimin më efikas të burimeve ekzistuese të energjisë në të dyja vendet.

U mbajt mbledhja konstitutive e përbërjes së re të Bordit të Drejtorëve të KOSTT

Më 21 korrik 2020, në Selinë Qendrore të KOSTT-it u mbajt mbledhja konstitutive e Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it, konform vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.07-V-023, për përgjedhjen e Bordit të Drejtorëve të KOSTT, e cila u miratua me datë 10 korrik 2020, me përbërje nga Kryesuesi i Bordit z. Jeton Mehmeti, dhe anëtarët z. Arben Dodaj dhe z. Nebih Zariqi. Sipas pozitës dhe funksionit Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT-it z. Ilir M. Shala është po ashtu anëtar i Bordit të Drejtorëve dhe me këtë përbërje Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it është funksional. Anëtarët e tjerë pritet të përgjedhen pas rishpalljes së konkursit nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe përgjedhjes së tyre nga Kuvendi i Kosovës.



Me këtë rast, pas miratimit të rendit të ditës, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Illir M.Shala informoi Bordin e Drejtorëve me zhvillimet në KOSTT, prej përgjedhjes së tij në këtë pozitë me 01 Mars 2018, duke informuar për të arriturat e KOSTT-it në realizimin e objektivave të kompanisë, të arriturat në rrafshin e brendshëm në sektorin e energjisë dhe atë të jashtëm, në raport me pavarësimin energetik të KOSTT-it dhe operimin e pavarur si Zonë Rregulluese, brenda Bllokut Rregullues Kosovë - Shqipëri, duke përfshirë nënshkrimin e Marrëveshjes historike të krijimit të Bllokut Rregullues Kosovë - Shqipëri si dhe Marrëveshjen tjeter historike KOSTT - ENTSO-E, nënshkruar më 30.06.2020 si dhe me sfidat dhe problemet, që KOSTT është ballafaqur deri më tani.

Në takim mori pjesë edhe përfaqësuesja e autorizuar e aksionarit të KOSTT-it, Kuvendit të Kosovës, znj. Learta Hollaj, me ç'rast në fjalën e saj i uroi punë të mbarë

Bordit të Drejtorëve si dhe njëkohësisht përgëzoi menaxhmentin dhe gjithë punonjësit e KOSTT-it për të të arriturat në këtë periudhë, duke theksuar se ndërmarrja KOSTT është kompani me reputacion edhe në arenën ndëkombëtare, dhe se këtë frymë të punës, angazhimit profesional dhe konstruktiv të deritanishëm duhet ruajtur dhe avansuar edhe më tutje nga i gjithë Bordi i Drejtorëve, menaxhmenti dhe punonjësit.

Konstituimi i Bordit të Drejtorëve, do të ndikojë pozitivisht në zbatimin e obligimeve ligjore dhe atyre të përcaktuara me licencë lëshuar nga ZRR, si Operator i Sistemit Transmetues dhe Tregut të

Energjisë Elektrikë në Republikën e Kosovës, në funksion të operimit të sigurtë dhe të besueshmë të Sistemit Transmetues të Energjisë Elektrike në Kosovë si dhe mbarëvajtjen e proceseve, nëpër të cilat po kalon KOSTT.



Ndërsa me datë 29 tetor 2020 Kuvendi i Kosovës me vendimin Nr. 07-V-083 të datës 29.10.2020 ka emëruar edhe dy anëtare të reja të Bordit të Drejtorëve znj. Ajrina Gashi Hamdiu dhe znj. Xhyldane Kiçmari.

Mustafë Hasani merr detyrën e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT

Me vendimin e Bordit të Drejtorëve të KOSTT sh.a të datës 6 nëntor 2020, z.Mustafë Hasani, me 9 Nëntor 2020 mori detyrën e Kryeshefit Ekzekutiv të Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu-KOSTT.

Pas vendimit pozitiv të instancës së parë të Gjykatës Themelore si dhe të instancës së dytë të Gjykatës së Apelit me ç'rast vendimi për rikthimin e z.Mustafë Hasani në vendin e punës Kryeshef Ekzekutiv është bërë i formës së prerë, Bordi i Drejtorëve të KOSTT në përbërje të të gjithë anëtarëve të Bordit, në takimin e datës 6 nëntor 2020 vendosi për zbatimin e urdhërit të Gjykatës.

z.Mustafë Hasani me profesion Doktor i Shkencave të Ekonomisë mban përvojë shumë vjeçare në pozita të ndryshme udhëheqëse në institucionet vendore. Z.Hasani ka mbajtur pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT nga dhjetori i vitit 2015 deri në gusht të vitit 2017. Ndërkohë paraprakisht ka mbajtur pozitën e Drejtorit Gjeneral në Administratën Tatimore të Kosovës, Kryeshef Ekzekutiv i Agjensionit për Promovimin e Investimeve, Drejtor i Bordit të Trafikut Urban dhe Drejtor i Departmentit Qendror për Partneritet Publiko-Privat në Ministrinë e Financave. Z.Hasani gjithashtu ka qenë i angazhuar në projekte të ndryshme të Komisionit Evropian si dhe si ligjerues i lëndëve ekonomike në kolegje private në Kosovë.



Me rastin e marrjes së detyrës z.Hasani theksoi "Po rikthehem në KOSTT në një etapë të rëndësishme për të gjithë sektorin e energjisë në Kosovë. Bashkërisht me menaxhmentin e lartë do të përkushtohemi në arritjen e objektivave strategjike të kompanisë, implementimin e Marrëveshjes së re të Kyçjes KOSTT/ENTSO-E dhe realizimin e përgatitjeve sa më profesionale për fillimin e funksionimit si zonë rregulluese brenda Bllokut Rregullues Shqipëri-Kosovë si dhe opera-cionalizimin e Bursës Shqiptare të energjisë ALPEX. Gjithashtu, siguroj të gjitha palët e interesit vendore dhe ndërkombëtare në përkushtimin tim për bashkëpunim profesional, gjithnjë në funksion të zhvillimit të gjithmbar-shëm ekonomik të vendit".

Realizohet vizitë pune në Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Republikës së Shqipërisë (OST), në Tiranë

Më 11 Qershor 2020, KOSTT realizoi vizitë pune në Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Republikës së Shqipërisë (OST), në Tiranë. Në takimin i cili u realizua në mes të menaxhmentit të lartë të KOSTT dhe atij të kompanisë homologe nga Shqipëria u diskutuan tema me interes për të dyja institucionet si:

- shkëmbimi i informatave dhe përgatitjet e operimit të Bllokut Rregullues Kosovë-Shqipëri (Blloku AK)
- zhvillimi i tregut të përbashkët të energjisë elektrike Kosovë-Shqipëri
- harmonizimin e planeve zhvillimore në rrjetin e transmetimit



- avansimin e sistemeve telekomunikuese si dhe mundësítë e komercializimit të fibrave optike në linjat interkonektive

Komuna e Rahovecit, Malishevës dhe Therandës me furnizim më të besueshëm dhe cilësor me energji elektrike, ndërkaq Rrjeti i Transmetimit të Kosovës plotëson kriterin e sigurisë së furnizimit N-1

Që nga viti 2008 kur është ndërtuar për herë të parë nënstacioni 110/35/10(20) kV Rahoveci i lidhur me një linjë të vetme transmetuese 110 kV, me 18 Qershor 2020 u përmbylli me sukses projektin i ndërtimit të linjës së re të tensionit të lartë 110 kV me gjatësi prej 16.5 km, e cila shtrihet në 57 shtylla elektrike, duke lidhur këtë nënstacion me nënstacionin 110/35/10(20)kV Theranda.

Falë realizimit të këtij projekti në vlerë prej më se 1.43 milion Euro, i cili u bashkë-financua nga ana e KOSTT dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), qytetarët e Komunës së Rahovecit, Malishevës dhe Therandës, do të kenë furnizim më të besueshëm dhe më cilësor me energji elektrike, nga aspekti i transmetimit.

Ky projekt gjithashtu do të ndikojë në rritjen e kapaciteteve transmetuese, uljen e energjisë së padërguar te konsumatorët si dhe në optimizimin e proceseve të mirëmbajtjes së linjave transmetuese.

Ndërkaq me vënien në operim të linjës, tani përfundimisht Rrjeti i Transmetimit të Kosovës plotëson kriterin teknik të sigurisë së furnizimit N-1

Me rastin e përmbylljes së suksesshme dhe vënies në operim të këtij projekti kapital, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Illir M.Shala theksoi "Në vazhdimësi të përbushjes së misionit të KOSTT për të garantuar siguri të furnizimit në fushën e përgjegjësive të veta, me qëllim të mbështetjes së zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Republikës së Kosovës, ne sot e energjizuam linjën e re 110 kV NS Rahoveci-NS Theranda. Ky projekt përvrësh rëndësisë që e ka në përforcimin dhe zhvillimin e rrjetit të transmetimit, njëkohësisht krijon kushte për integrim dhe operim të sigurt të burimeve të ripërtërishme të energjisë nga era në Zatriq, e që janë objektiva afatgjate të politikave energetike të vendit në mbështetje të zhvillimit ekonomik, rritjes së sigurisë së furnizimit dhe mbrojtjes së mjedisit".



KOSTT i bashkohet kampanjës globale #OrangeTheWorld



MUSTAFË HASANI

Kryeshef Ekzekutiv KOSTT

"Që nga Edith Clarke që njihet si inxhinierja e parë elektrike femër e deri tek inxhinieret e sotme të zonjat në mbarë globin si dhe në Kosovë, kontributi i femrës si në shkencë ashtu edhe në zhvillimin e shoqërisë përbën vlerë të pazëvendësueshme dhe inspirim përgjeneratare reja.

Të bashkuar si shoqëri, të ngrisim të gjithë zërin kundër dhunës me bazë gjinore dhe të angazhohemi përfuqizimin e gruas dhe sigurimin e mundësive të barabarta si elemente thelbësore përnjë zhvillim të qëndrueshëm shoqëror dhe ekonomik"

KOSSST i bashkohet kampanjës globale #OrangeTheWorld për të rritur ndërgjegjësimin përdhënien fund të dhunës me bazë gjinore derisa mbeten e përkushtuar përfuqizimin e gruas dhe promovimin e të drejtave të barabarta.

Ndërtesa qendrore e KOSTT, është ndriuar portokalli çdo natë në kuadër të "16 Ditëve të aktivizmit kundër dhunës në baza gjinore" për të simbolizuar një të ardhme të ndritshme për gratë dhe vajzat në mbarë botën.



"Përkushtimi i gjithë shoqërisë përfuqizim të gruas dhe sigurimin e mundësive të barabarta pa dallim gjinie, janë thelbësore përnjë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror.

Puna profesionale dhe përkushtimi nuk njohin gjini, por janë vlera esenciale që shpiejnë drejt sukseseve. Në Ditën Ndërkombëtare të Grave në Inxhinieri, u falenderuan punonjëset e KOSTT për kontributin e çmuar në përbushjen e misionit përoperim të sigurt dhe të besueshëm të Sistemit të Transmetimit dhe operim efikas të tregut të energjisë elektrike të Republikës së Kosovës.

Puna dhe sukseset tuaja janë inspirim përvajzat e reja dhe obligim përtë gjithë shoqërinë që agjenda përbarazinë gjinore në sektorin e energjisë elektrike të avansoj tutje!"




Në 14 vjetorin e themelimit, KOSTT prezanton të arriturat kryesore

Të arritura të shumta e karakterizojnë udhëtimin 14 vjeçar të KOSTT dhe kjo është meritë e përkushtimit profesional të seilit punonjës në drejtim të përmbushjes së objektivave strategjike të kompanisë.

Duke pasur rolin e boshtit kryesor në sigurinë e furnizimit me energji elektrike, çdo e arritur e KOSTT përbën vlerë drejt krijimit të kushteve për zhvillim të qëndrueshëm të shoqërisë dhe zhvillim ekonomik e industrial të vendit tonë.

Në 14 vjetorin e themelimit, ju prezantojmë të arriturat kryesore të KOSTT që e kanë karakterizuar këtë vit si dhe të dhënrat kryesore të Rrjetit të Transmetimit të Kosovës.



KOSTT dhe MEPSO (Maqedoni e Veriut) krijojnë kushte për tregtim të drejtpërdrejtë të energjisë elektrike në mes të dy vendeve

Operatorët e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT) dhe të Maqedonisë së Veriut (MEPSO), nënshkruan Marrëveshjen Operacionale (Operational Agreement) për organizimin e ankandeve për alokimin e kapaciteteve interkonektive, duke krijuar kështu kushte për tregtim të drejtpërdrejtë të energjisë elektrike në mes të dy vendeve. Marrëveshja u nënshkrua nga Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani dhe Drejtori gjeneral i MEPSO z.Kushtrim Ramadani.



Me këtë rast, z.Mustafë Hasani theksoi "Kjo marrëveshje është vazhdimësi e përbushjes së obligimeve që rrjedhin nga kërkesat e ENTSO-E, e cila do të jetë në funksion të zhvillimit të tregut rajonal të energjisë dhe rritjes së sigurisë së furnizimit me energji elektrike për qytetarët e të dyja vendeve."

- Derisa drejtori i përgjithshëm i MEPSO z.Kushtrim Ramadani theksoi "Kjo është një ditë shumë e rëndësishme për të dy operatorët e sistemit, meqenëse pjesëmarrësve në tregjet e energjisë elektrike në Kosovë dhe Maqedoni të Veriut u mundësohet që të marrin pjesë në

ankande dhe të blejnë kapacitete ndërkufitarë për transmetimin e energjisë elektrike. Ky është një hap i rëndësishëm drejt krijimit të një tregu rajonal dhe integrimit të mëtujeshëm në tregun e pan-evropian të energjisë elektrike".

Ankandet në emër të të dy operatorëve do të realizohen nga CAO (Coordinated Auction Office for SEE/Zyra për Ankandin e Koordinuar të kapaciteteve interkonektive (ndërkufitar) për EJL), ku KOSTT dhe MEPSO janë themeluese dhe aksionare së bashku edhe me Operatorët e Sistemit të Transmetimit nga Shqipëria (OST), Mali i Zi (CGES), Greqia (IPTO), Kroacia (HOPS), Bosnja dhe Hercegovina (NOSBiH) dhe Turqia (TEIAS).

SEE CAO organizon ankande vjetore, mujore dhe ditore për alokimin e të drejtave të kapacitetit ndërkufitar në kufijtë e këtyre vendeve. SEE CAO është krijuar me qëllim që të centralizojë organizimin e ankandeve midis disa operatorëve fqinjë të sistemit të transmetimit, me qëllim të uljes së kostove dhe të sigurimit të kushteve të drejta për të gjithë pjesëmarrësit në tregjet rajonale të energjisë elektrike.

Nënshkruhet Marrëveshja e re e Kyçjes KOSTT/ENTSO-E

Pas votimit të suksesshëm në muajin prill 2020 nga ana e Grupit Regional të Evropës Kontinentale (RGCE), më 30 qershori 2020 Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Ilir M. Shala nënshkroi Marrëveshjen e re të Kyçjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E.

Me fillimin e implementimit të Marrëveshjes së re të Kyçjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E, KOSTT do të operoj si zonë rregulluese e pavarur brenda Bllokut AK me Republikën e Shqipërisë, në kuadër të zonës sinkrone të Evropës Kontinentale.

Marrëveshja e re e Kyçjes KOSTT/ENTSO-E pritet të fillojë së zbatuari në vjeshtë të këtij viti pas përfundimit të përgatitjeve teknike të Operatorëve të Sistemit Transmetues të Evropës Kontinentale dhe Koordinatorit Swissgrid (Operatori i Sistemit Transmetus të Zvicrës), derisa KOSTT tashmë ka realizuar të gjitha përgatitjet teknike operative për të qenë i gatshëm për fillimin e operimit të pavarur. Marrëveshja e re e Kyçjes KOSTT/ENTSO-E përfshinë:

- Freskimin e Katalogut të masave, sipas rekomandimeve të Grupit të Projektit për KOSTT-in;
- Zëvendësimin e të gjitha referencave të doracakut të Operimit të Marrëveshjes Shumëpalëshe me referencat e SAFA (Marrëveshja Kornizë e Zonës Sinkrone);



- Që kompania Elektrosever, të aplikojë në ZRRE dhe të licencohet brenda 30 ditëve sipas kornizës ligjore dhe rregulative të Kosovës, për të furnizuar me energji elektrike konsumatorët në pjesën veriore të Kosovës.

Ndërkaq përfitimet nga operacionalizimi i Marrëveshjes janë të mëdha:

- Inkasimi i të hyrave nga shfrytëzimi i rrjetit transmetues interkonektiv apo alokimi i kapaciteteve dhe menaxhimi i kongjestioneve, që kap vlerën në mesatare vjetore 4.0 – 8.0 Mil EUR dhe nga transiti rrëth 0.5 – 1.0 Mil EUR;
- Lëshimi në operim të plotë i linjës interkonektive 400 kV, Kosovë – Shqipëri;
- Implementimi i plotë i Marrëveshjes së Bllokut Rregullues Kosovë – Shqipëri, nënshkruar në Tiranë, më 26.11.2019;



- Bashkimi i tregjeve elektroenergjetike me Shqipërinë si dhe
- Pjesëmarrja me aksione në Bursën Shqiptare të energjisë elektrike (APEX)

Me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes, Kryeshefi i KOSTT z.Shala theksoi "Jam i lumtur që në vigjilje të 14 vjetorit të themelimit të kompanisë, po e konkludojmë këtë proces të merituar për të cilin kemi punuar për shumë vite. Falënderoj ekipin profesional të KOSTT për përkushtimin në këtë proces dhe edhe njëherë, i falënderoj për mbështetjen e vazhdueshme institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, ZRR, Ambasadën Gjermane, Bankën gjermane për Zhvillim-KfW, Ambasadën Amerikane, USAID, kompanitë homologe të ENTSO-E dhe të gjitha palët e tjera të interesit vendore dhe ndërkombëtare të cilët kanë qenë

element shtytës për ne në këtë rrugëtim."

Ky është hapi i parë i cili e afron KOSTT-in drejt anëtarësimit në Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmetimit, si objektivë strategjike e kompanisë.

Ndërkaq në mbledhjen e mbajtur me 29 shtator 2020, RGCE (Regional Group for Continental Europe) trup i ENTSO-E, ka vlerësuar që KOSTT ka plotësuar të gjitha kushtet e parapara me marrëveshje dhe është votuar që Marrëveshja e re e Kyçjes KOSTT/ENTSO-E të hyj në fuqi. Me hyrjen në fuqi të marrëveshjes, fillojnë përgatitjet teknike me Qendrën Koordinuese SwissGrid si dhe me OST-të fqinje për t'i mundësuar KOSTT-it fillimin e operimit si zonë regulluese në kuadër të Bllokut AK.

Me rastin e katërmëdhjetë vjetorit të themelimit, KOSTT ndau mirënjohje për punëtorët e dalluar

Me datë 30 Qershor 2020, për ndërë të katërmëdhjetë vjetorit të themelimit të KOSTT u ndanë mirënjohjet për punëtorët e përzgjedhur. Për shkak të masave për parandalimin e pandemisë COVID-19, për dallim nga vitet paraprake, këtë vit KOSTT po shënon një përvjetor më ndryshe dhe për të vlerësuar punën e palodhshme dhe angazhimin e punonjësve, ndau mirënjohje punëtorëve për kontribut të veçantë për kujdesin ndaj shëndetit të punonjësve, promovim të vlerave të barazisë gjinore si dhe mirënjohje për punëtorët e dalluar.

Me këtë rast Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT-it, Ilir M.Shala u shpreh "Puna dhe përkushtimi i juaj, dhe i shumë kolegëve tanë është motivi ynë shtesë që të vazhdojmë me realizimin e objektivave të kompanisë, arritje të

sukseseve madhore dhe njëherësh të vazhdojmë t'i nxisim të gjithë punonjësit e kompanisë sonë që të punojmë edhe me më shumë elan në të ardhmen".

Me qëllim të motivimit të punonjësve të kompanisë, praktika të tillë për ndarjen e mirënjohjeve dhe shpërblimeve për punonjësit e dalluar, KOSTT ka aplikuar edhe në vitet e kaluara por do të vazhdojë edhe në të ardhmen.



Miratohet raporti vjetor finansiar i KOSTT nga Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Transfere

Në mbledhjen e Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Transfere të mbajtur më 25 Nëntor 2020 në Kuvendin e Kosovës, Kryesuesi i Bordit të KOSTT z.Jeton Mehmeti dhe Kryeshefi Ekzekutiv z.Mustafë Hasani, prezantuan para deputetëve Raportin vjetor finansiar të KOSTT përvitin 2018 dhe 2019.

Pas diskutimeve dhe trajtimit të disa çështjeve me interes nën përgjegjësinë e KOSTT, Raporti finansiar përvitet 2018 dhe 2019 unanimisht u votua nga anëtarët e Komisionit Parlamentar dhe u rekomandua përmiratim në Kuvendin e Kosovës.

Nënshkruhet kontrata në mes të KOSTT dhe Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) për shërbimet e Rezervës Manuale për Restaurimin e Frekuencës, përrregullimin zbritës

Në vazhdimesi të parapërgatitjeve përfillimin e operimit të pavarur të KOSTT si zonë rregulluese në kuadër të Bllokut AK dhe të punës paralele me sistemet tjera të Evropës Kontinentale procese që do të pasojnë me fillimin e zbatimit të Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT/ENTSO-E, më 9 shtator 2020 në Prishtinë, u nënshkrua kontrata për shërbimet e Rezervës Manuale për Restaurimin e Frekuencës (mFRR), përrregullimin zbritës në mes të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut KOSTT sh.a përfaqësuar nga Kryeshefi Ekzekutiv z.Illir Shala dhe dhe u.d Kryeshefi Ekzekutiv i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) z.Luigj Imeri.

Bazuar në legjislacionin vendor si dhe në rregullativat e ENTSO-E, KOSTT si Operator i Sistemit të Transmetimit është i obliguar që të siguroj operimin stabil dhe të besueshmë të Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës si dhe të balancoj sistemin duke siguruar shërbimet e rezervës përfshirë restaurimin e frekuencës, të njohura si shërbimet ndihmëse.

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Shala me rastin e nënshkrimit të kontratës theksoi "Ne po vazhdojmë tutje me të gjitha parapërgatitjet e nevojshme përfshirë filluar operimin e pavarur në momentin që do të fillojë zbatimi i Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT/ENTSO-E, dhe



kontrata që nënshkruam sot është në funksion të këtyre përgatitjeve."

Kontrata ndërmjet KOSTT dhe KEK përfshirë shërbimet e Rezervës Manuale përfshirë Restaurimin e Frekuencës (mFRR) përrregullimin zbritës, do të filloj së zbatuar me fillimin e zbatimit të Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT/ENTSO-E dhe operimit të KOSTT si Zonë Rregulluese brenda Bllokut AK, ndërkaq procesi është zhvilluar në pajtim me Procedurën përfshirë Tregtimin e Energjisë, të miratuar nga Zyra e Rregulatorit të Energjisë.

KOSTT i bashkohet UNICEF Kosova dhe Kosovo CSR Network në kampanjën #united4children dhe #back2school

Nëmbështetje të përkushtimit të vazhdueshëm të KOSTT sh.a, në implementimin e parimeve të Përgjegjësisë Shoqërore të Korporatave, si për nga aspekti i veprimtarisë që ushtron, ashtu edhe me përkrahje filantropike të kohëpaskohshme për komunitetin duke bërë përpjekje për të ndikuar në zhvillim të qëndrueshëm dhe mirëqenien e shoqërisë sonë, KOSTT iu bashkua kampanjës së UNICEF dhe Kosovo CSR Network #united 4children dhe #back2school që fëmijët të vihen në qendër të planeve të reagimit dhe rimëkëmbjes nga COVID-19 në Kosovë.

Në këtë kontekst, më 14 Shtator 2020, përfaqësueset nga KOSTT znj. Zana Bajrami-Rama Menaxhere e Zyrës për Komunikim dhe Relacione me Publikun dhe znj. Fëllënza Xhelili-Fiqi Drejtoreshë e Departamentit për Çështje Rregullative dhe Tarifa, së bashku me përfaqësuesit nga Komuna e Prishtinës përkatësisht Zëvendës Kryetari i Komunës z. Muhedin Nushi dhe Drejtoresha për Arsim znj. Shpresa Shala si dhe



Kosovo CSR Network vizituan ShML "Xhevdet Doda", për të bërë dorëzimin e përkrahjes së KOSTT, të përbërë me pako higjenike madhore, e cila përfshinë termometër infrared, produkte larëse për pastrimin e hapësirës dhe ambientit, dezinfektues për duar dhe sapun të lëngët. Pakot në fjalë iu shpërndahen gjithashtu edhe shkollave të mesme të larta: ShML "Eqrem Qabej", ShML "Gjin Gazuli", dhe ShML "Hoxhë Kadri Prishtina"

KOSTT sh.a uroi të gjithë mësimdhënësit dhe nxënësit një vit të mbarë shkollor dhe me plot shëndet!

Nënshkruhen Marrëveshje për Kyçje në Sistemin e Transmetimit të Kosovës të kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtërishme të energjisë

Pas shqyrtimeve të aplikacioneve nga KOSTT, muajin Qershori 2020, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.llir M. Shala dhe Drejtori i Eurokos DD sh.p.k, nënshkruan Marrëveshjen për Kyçje në Sistemin Transmetues të Kosovës të Hidrocentralit Reverzibil (Pump Stored Hidro Power Plant) Drini me kapacitet instalues 250 MW. Gjithashtu gjatë muajit Shtator 2020, KOSTT dhe Dardana Invest

nënshkruan Marrëveshjen për Kyçje në Sistemin e Transmetimit të gjeneratorit me erë KITKA, zgjerimi kapaciteteve gjeneruese ekzistuese për 20 MW.

Investimet të cilat i ka realizuar KOSTT në Sistemin e Transmetimit të Kosovës në mënyrë të vazhdueshme, kanë krijuar kushte të favorshme për akomodimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike.



Kryeministri i Republikës së Kosovës priti në takim Bordin e KOSTT

Më 18 Shtator 2020, në ndërtesën e Qeverisë së Kosovës, Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, priti në takim Bordin e Drejtore të KOSTT-it, kryesuar nga kryesuesi i Bordit, z. Jeton Mehmeti, anëtarët z. Arben Dodaj, z. Nebih Zariqi, z. Ilir M. Shala - Kryeshef Ekzekutiv si dhe z. Visar Hoxha, Sekretar i Kompanisë/Menaxher i Zyrës Ligjore, ku u njoftua për zhvillimet e fundit në sektorin e energjisë dhe stabilitetin energjetik në vend.

Me këtë rast, duke ofruar mbështetjen e Qeverisë së Kosovës për KOSTT-in, kryeministri Hoti u shpreh: "stabiliteti energjetik është parakusht për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit, i rritjes së

investimeve të brendshme dhe atyre të jashtme dhe në funksion të mirëqenies së qytetarëve".

Në anën tjetër kryesuesi i Bordit të Drejtore të KOSTT-it, Z. Mehmeti dhe Kryeshef Ekzekutiv z. Shala shprehën mirënjoyje ndaj mbështetjes së vazhdueshme të Qeverisë së Republikës së Kosovës për KOSTT-in, në këtë kohë kur Marrëveshja e re e Kyçjes KOSTT/ENTSO-E pritet të fillojë së zbatuari në vjeshtë të këtij viti, derisa KOSTT tashmë ka realizuar të gjitha përgatitjet teknike operative për të qenë i gatshëm për fillimin e operimit të pavarur në kuadër të Bllokut Rregullues të Sistemeve Energetike Kosovë-Shqipëri (Blloku AK).



KOSTT dhe KEDS nënshkruan Marrëveshjet e Kyçjes për nënstacionet e reja, NS 220/10(20) kV Malisheva dhe NS 110/10(20) kV Ferizaj 3

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Ilir M. Shala dhe Kryeshefi Ekzekutiv i KEDS Energy z. Alper Erbas, me 12 Tetor 2020, nënshkruan Marrëveshjet e Kyçjes, konform Metodologjisë së Taksave të Kyçjes, për nënstacionet e reja:

- NS 220/10(20) kV - Malisheva dhe
- NS 110/10 (20) kV - Ferizaj 3.

Këto projekte brenda afateve të caktuara, do të fillojnë së ndërtuari. Me ndërtimin e këtyre nënstacioneve, do të përmirësohet cilësia e furnizimit me energji elektrike për të gjithë konsumatorët e këtyre rajoneve si dhe është

parakusht për zhvillim më të qendrueshëm ekonomik. Me këtë rast z. Shala përgëzoi ekipet për angazhimin dhe punën e bërë profesionale.



KOSTT merr pjesë në punëtorinë me temën "Dekarbonizimi i Energjisë në Kosovë"

Më 22 Shtator 2020, nën organizim të Bankës Gjermane për Zhvillim KfW dhe kompanisë Lumenion GmbH dhe me pjesëmarrje të shumë akterëve nga fusha e energjisë në Kosovë, u realizua në mënyrë virtuale Punëtoria me temën Dekarbonizimi i Energjisë në Kosovë.

Prezent në punëtori ishin edhe zv. Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Kadri Kadriu si panelist dhe z. Gazmend Kabashi Menaxheri i Zyrës për Planifikim Afatgjatë dhe Zhvillim, ku përmes prezantimit me temën Evolucioni i Sistemit të Energjisë në Kosovë, z. Kadriu shpalosi të arriturat dhe sfidat e KOSTT në drejtim të bërjes Zonë/Blllok Rregullues i Pavarur e cila rezultoi me nënshkrimin e Marrëveshjes së Repër Kycje KOSTT-ENTSO-E, si dhe zgjerimin e kapaciteteve transmetuese në funksion të akomodimit të mëtutjeshëm të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë Elektrike dhe sfidat e operimit në funksion të integrimit në shkallë të gjërë të BRE.

Në Punëtori u prezantuan rezultatet e studimit para-fizibilitetit për sistemet e akumulimit të energjisë me temperature të lartë në mbështetje të dekarbonizimit të Termocentralit Kosova A, e realizuar nga Lumenion GmbH si dhe shkëmbime të njohurive në lidhje me kushtet teknologjike, ekonomike, financiare dhe rregullatore për sistemet akumuluese të energjisë.



Ambasadori i RF Gjermane z. Rohde vizitoi KOSTT-in

Me 8 Tetor 2020, menaxhmenti i lartë i KOSTT në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z.Illir Shala priti në takim pune Ambasadorin e Republikës Federale të Gjermanisë në Kosovë, Sh.T z.Jörn Rohde, znj. Anna Stege si dhe zv. drejtoren e Bankës Gjermane për Zhvillim znj. Ganimete Huruglica, me ç'rast u njoftuan për zhvillimet e fundit, si ajo e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së re të Kyçjes KOSTT - ENTSO-E, themelimin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, lëshimin në operim të plotë të linjës transmetuese 400 kV, Kosovë - Shqipëri, si dhe për sigurinë e furnizimit me energji elektrike në tërë Republiken e Kosovës.

Me këtë rast ambasadori Rohde shprehu urimet dhe përgëzimet më të sinqerta me arritjet dhe sukseset e KOSTT-it si dhe vlerësoi lartë përkushtimin dhe punën profesionale të menaxhmentit dhe stafit si dhe gatishmërine përpërkrahjetutje në proceset, që po kalojmë.



KOSTT nënshkruan memorandum mirëkuptimi me Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të Universitetit Hasan Prishtina

Me datë 15 Tetor 2020, KOSTT dhe Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit për ndarjen e bursave për studentët e rregullt të FIEK, me qëllim të përkrahjes dhe motivimit të studentëve përfundimin e studimeve. Në bazë të marrëveshjes e cila u nënshkrua nga Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Illir M.Shala dhe Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK) të Universitetit Hasan Prishtina, prof. asoc. Dr. Isak Shabani, KOSTT ndanë bursa për 10 studentë, në vlerë prej 100 EUR në muaj, për vitin akademik 2020/21, për 12 muaj, në harmoni me kriteret e përcaktuara në konkursin që do të shpallet për bursa. Publikimi i konkursit do të bëhet në ueb faqen e FIEK si dhe në tabelen e shpalljeve të FIEK, Prishtinë.

Me këtë, KOSTT kontribuon në zhvillimin e kuadrove të reja profesionale të inxhinierisë elektrike, kuadro këto që në ditët e sotme janë më se të nevojshme për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Sistemit Transmetues të Energjisë Elektrike.



Agjencia për Barazi Gjinore pranë Zyrës së Kryeministrit njoftohet me të arriturat dhe planet e KOSTT në fushën e barazisë gjinore

Qëngjë nëntori 2018, KOSTT ka bashkëpunuar me USAID, përmes programit të shërbimeve përkrahëse për të ndihmuar në zhvillimin dhe zbatimin e një plani të veprimi, për të përfshirë praktikat më të mira të barazisë gjinore.

KOSTT në bashkëpunim me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Tetratech – (konsulencë me bazë në Sh.B.A), brenda Programit të Shërbimeve Përkrahëse dhe iniciativës W-GPD (Women's Global Development and Prosperity), të Shtëpisë së Bardhë në Washington DC, ka arriut të sigurojë përfaqësim më të mirë të grave brenda kompanisë.

Me këtë rast, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Ilir M.Shala me datë 9 tetor 2020 priti në takim znj.Edi Gusia, Kryeshefe Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore-Zyra e Kryeministrit si dhe znj. Jasmine

Boehm nga Tetratech (përmes tele-takimit), e cila prezantoi të arriturat e KOSTT dhe bashkëpunimin e ngushtë mes KOSTT dhe USAID, gjatë këtyre dy viteve. Në takim znj.Gusia u njoftua për të arriturat dhe planet e KOSTT në fushën e barazisë gjinore. Mbështetja institucionale është shumë e rëndësishme andaj së bashku me znj.Gusia do të punojmë ngushtë me qëllim të arritjes së objektivave të KOSTT në aspektin e barazisë gjinore.



KOSTT dhe KEDS/KESCO bashkërendojnë përgatitjet teknike për fillimin e operimit të pavarur të KOSTT si Zonë Rregulluese brenda Bllokut AK

Në selinë qendrore të KOSTT, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Mustafë Hasani së bashku me bashkëpunëtor, priti në takim përfaqësuesit nga KEDS/KESCO në krye me z. Huseyin Ozen ku diskutuan në lidhje me bashkërendimin e përgatitjeve për fillimin operimit të pavarur të KOSTT si Zonë Rregulluese brenda Bllokut Rregullues Shqipëri-Kosovë dhe koordi-nimin e përbashkët të aktiviteteve për sigurimin e transaksioneve ndërkufitar.

Në takimin e mbajtur me datë 1 dhjetor 2020, të RGCE (Regional Group of Continental Europe) është dakorduar që fillimi i operimit të KOSTT si Zonë Rregulluese brenda Bllokut Rregullues Shqipëri-Kosovë, pra fillimi i implementimit të Marrëveshjes së Kyçjes ndërmjet KOSTT dhe ENTSO-E të bëhet me datën 14 dhjetor 2020 dhe si rezultat u diskutuan një mori çështjesh në funksion të furnizimit stabil me energji elektrike në Republikën e Kosovës.

Gjatë takimit z. Hasani theksoi se sfidë kryesore mbetet implementimi i Planit Aksional, i hartuar nga grupi punës në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, përfurnizim stabil me energji elektrike në pjesën veriore të Kosovës.



Mbahet Asambleja e Përgjithshme e Bursës Shqiptare të Energjisë ALPEX

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Mustafë Hasani dhe Administratori i Përgjithshëm i OST Shqipëri z. Skerdi Drenova, në cilësinë e aksionarëve të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) miratuan Programin dyvjeçar të Zhvillimit Ekonomik të ALPEX.

Me këtë rast, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Mustafë Hasani theksoi "Në përputhje me politikat qeveritare

për zhvillimin e sektorit të energjisë, ne së bashku me OST Shqipëri jemi fokusuar maksimalisht në shtyerjen përpëra të proceseve për t'a funksionalizuar Bursën Shqiptare të Energjisë. Tani, me miratimin e Programit të Zhvillimit Ekonomik ne i kemi hapur rrugë ndërmarrjes së të gjitha veprimeve përtë operacionizuar ALPEX".

ALPEX është institucion i rëndësishëm për zhvillimin e tregut konkurruesh të energjisë elektrike për të dyja vendet përmes së cilës do të sigurohet transparencë, konkurrencë në treg dhe shfrytëzim efikas i kapa-citeteve interkonektive, në përputhje me politikat shtetërore Kosovë dhe Shqipëri, legjislacionin evropian dhe obligimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë.



Përfaqësues të Kontigjentit të Britanisë së Madhe të KFOR vizituan KOSTT

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të KOSTT z.Jeton Mehmeti dhe menaxhmenti i lartë në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z.Mustafë Hasani, me 22 Janar 2021 priten në takim kontigjentin e Britanisë së Madhe në KFOR përfaqësuar nga udhëhqësi i ekipit z.Scout Guy dhe z. Southman Benjamin, komandant sekondar i njesisë.

Me këtë rast, ekipi i njesitit britanez të KFOR u informuan në lidhje me operimin e përgjithshëm të Sistemit të Transmetimit të Republikës së Kosovës me theks të veçantë situatën pas fillimit të operimit të pavarur të KOSTT si zonë rregulluese në kuadër të Bllokut Shqipëri-Kosovë.



KOSTT i bashkohet partneritetit global për fuqizimin e të rinjve “Generation Unlimited”

Në vazhdimësi të përgjegjësisë shoqërore korporative, me datë 14 Tetor 2020 Kryeshef ekzekutiv i KOSTT z.Ilir M.Shala dhe Menaxherja e projektit K-GenU në Rrjetin CSR Kosova znj.Gëzime Hasani, nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit nëpërmes së cilët KOSTT i bashkohet partneritetit global për fuqizimin dhe aftësimin e rinjve, për t'i përgatitur përtéardhmen e tyre.

Në kuadër të projektit Generation Unlimited në Kosovë (K-GenU) i cili përkrahet nga UNICEF Kosovë dhe nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), KOSTT do të kontribuoj në fuqizimin, zhvillimin dhe ofrimin e shkathtësive përtërinjë e moshës deri në 24 vjeç, nëpërmjet skemës së punës praktike, duke respektuar po ashtu edhe barazinë gjinore.

Përfaqësuesit e KFOR u njofuan gjithashtu se si rezultat i zhvillimit të vazhdueshëm të rrjetit të transmetimit dhe mirëmbajtjes preventive, sistemi i transmetimit është duke funksionuar sipas planit në të gjithë vendin si dhe furnizimi i qytetarëve me energji elektrike nga aspekti i transmetimit është cilësor dhe i besueshëm në të gjithë Republikën e Kosovës.

Ekipi i KFOR gjithashtu vizituan edhe Qendrën Nacionale Dispeçerike në KOSTT prej nga operohet, monitorohet dhe komandohet Sistemi i Transmetimit të energjisë elektrike të Republikës së Kosovës.

Me këtë rast z.Shala theksoi “Si kompani e përgjegjshme ndaj komunitetit, nëpërmes projektit K-GenU, KOSTT zotohet përtë përkrahur aftësimin e të rinjve me qëllim të kontribuimit në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit tonë”.

KOSTT, njëherit anëtarë e Rrjetit CSR Kosova është kompania e parë publike, e cila i është bashkuar projektit K-GenU, deri më tanë.



Ambasadori i Norvegjisë z. Grøndahl vizitoi KOSTT-in

Me 21 tetor 2020, Menaxhmenti i lartë i KOSTT priti në takim pune Ambasadorin e Norvegjisë në Kosovë, Sh.T z. Jens Erik Grøndahl, ku e njofuan për sukseset e KOSTT-it në operimin e pavarur si Zonë Rregulluese, brenda Bllokut Rregullues Kosovë - Shqipëri, për themelimin e Bursës Shqiptare të Energjisë ALPEX si dhe për sigurinë e furnizimit me energji elektrike në tërë Republikën e Kosovës, në aspektin e transmetimit.

Kryeshefi ekzekutiv i KOSTT z. Ilir Shala falënderoi përzemërsisht Ambasadorin dhe Nordpool për kontributin e veçantë, që kanë dhënë në themelimin e ALPEX.

Me këtë rast, Ambasadori z. Grøndahl shprehu përgjëzimet më të sinqerta ndaj KOSTT-it për arritjet dhe sukseset e fundit drejtë integrimeve evropiane!



Nënshkruhet Marrëveshja për Procesin e Shkëmbimit të të Dhënavë për Barazim Përfundimtar të Energjisë së Shkëmbyer ndërmjet dy zonave rregulluese OST dhe KOSTT

Me datë 30 Tetor 2020, në Tiranë zv.Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Kadri Kadriu nënshkroi me OST Shqipëri Marrëveshjen për Procesin e Shkëmbimit të të Dhënavë për Barazim Përfundimtar të Energjisë së Shkëmbyer ndërmjet dy zonave rregulluese të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Kosovës dhe Shqipërisë, si dhe Memorandumin për Metodologjinë e Llogaritjes së Kapaciteteve Neto të Transmetimit, ndërmjet dy zonave rregulluese KOSTT dhe OST.

Me nënshkrimin e këtyre dy marrëveshjeve KOSTT dhe OST dakordohen të zbatojnë rregullat dhe rekomandimet ENTSO-E për shkëmbimet ndërkufitarë të energjisë, duke respektuar "Rregulloren Nr. 714/2009 të Parlamentit Evropian mbi Kushtet për Hyrjen në Rrjetin për Shkëmbimet Ndërkufitarë të Energjisë Elektrike", përkatësisht Rregulloren (EC) 714 / 2009 të Parlamentit Evropian.

Me këtë rast Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Ilir M. Shala u shpreh: "Nëshkrimi i këtyre dy marrëveshjeve mundëson operimin e pavarur të KOSTT si Zonë Rregulluese në kuadër të Bllokut Rregullues Kosovë-Shqipëri (Blloku AK), në kuadër të Evropës Kontinentale si dhe konkretizon bashkëpunimin në mes të dy operatorëve në të ardhmen në funksion të integrimit të mëtutjeshëm në tregun e integruar evropian të energjisë elektrike".

Me datë 29 Tetor 2020 ka hyrë në fuqi Marrëveshja e re e Kyçjes KOSTT - ENTSO-E, meqë nga ENTSO-E, edhe përkundër ankesës së EMS/Serbisë, u vlerësua se KOSTT



ka plotësuar të gjitha kushtet e parapara me marrëveshje dhe është e gatshme të operojë e pavarur nga EMS/Serbia, si Zonë Rregulluese brenda Bllokut Rregullues Kosovë - Shqipëri.

Nënshkruhet kontrata në mes të KOSTT dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) për shërbimet e Rezervës Manuale për Restaurimin e Frekuencës

Më 2 korrik 2020 në Prishtinë, u nënshkrua kontrata për shërbimet e Rezervës Manuale për Restaurimin e Frekuencës (mFRR) në mes të Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT z.Illir M.Shala dhe Administratorit të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) z.Benet Beci.



Në bazë të kontratës së nënshkruar, KOSTT do të blejë shërbimet mFRR nga KESH me qëllim të balancimit të Sistemit Elektroenergetik të Kosovës.

Me qëllim të operimit stabil të sistemit elektroenergetik si dhe balancimit të sistemit në kohë reale, KOSTT si Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës, në bazë të Ligjit të Energjisë Elektrike dhe licencës për operimin e sistemit të transmetimit, është i obliguar të sigurojë shërbimet ndihmëse, pjesë e së cilës është Rezerva Manuale për Restaurimin e Frekuencës (mFRR)/Rezerva Terciare.

Balancimi i sistemit është i domosdoshëm gjithashtu për funksionimin e KOSTT si zonë rregulluese e pavarur, në kuadër të Bllokut Rregullues me Shqipërinë (Blloku AK) dhe në punë paralele me sistemet tjera të Evropës Kontinentale.

Me këtë rast, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Shala theksoi "Ky është një nga proceset përgatitore që i paraprijnë fillimit të operimit të pavarur të KOSTT. Me sigurimin e rezervave rregulluese ne do të përm bushim obligimin, që rrjedh nga legjislacioni vendor si dhe nga rregullativat e ENTSO-E, të cilat definojnë kushtet e domosdoshme për punë paralele inter-konektive."

Ndërsa, Administratori i KESH Benet Beci në mes tjerash u shpreh se "kjo marrëveshje e arritur sot është e rëndësishme për faktin se është marrëveshja e parë e KESH që mundëson treg ndërkufitar balancues Kosovë – Shqipëri si dhe kontribuon në operimin më efikas të të dy sistemeve elektroenergetike. Kontrata është një hap konkret i hedhur në funksion të Strategjisë së Qeverisë Shqiptare dhe të Kosovës për integrimin e tregjeve të energjisë në mes dy vendeve, theksoi tutje z.Beci."



Zbatimi i kontratës ndërmjet KOSTT dhe KESH për shërbimet mFRR do të fillojë me fillimin e zbatimit të Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT/ ENTSO-E dhe operimit të KOSTT si Zonë Rregulluese brenda Bllokut AK, ndërsa q proçesi është zhvilluar në pajtim me Procedurën për Tregimin e Energjisë, të miratuar nga Zyra e Rregulatorit të Energjisë.

Nënshkruhen Marrëveshjet për Kyçje në Sistemin e Transmetimit të Kosovës të kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme të energjisë

Më 21 dhjetor 2020, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani dhe drejtori i kompanisë Air Energy 2 z. Kenan Guler, nënshkruan Marrëveshjet për Kyçje në Sistemin e Transmetimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme të energjisë me erë "PE Kamenica-1, 34.8 MW" dhe "PE Kamenica-2, 34.8 MW" dhe me diell "PS Kamenica-3, 30MW", me kapacitet total gjenerues prej 99.6 MW.



Të tri parqet e energjisë së ripërtëritshme do të kyçen në rrjetin transmetues 110 kV përmes linjës së re 110 kV me gjatësi rreth 25 km, e cila do të lidhet në NS 110/10(20)kV Gjilani 5. Kyçja në këtë pjesë të rrjetit transmetues të këtij kapaciteti të madh nga burimet e ripërtëritshme, do të mundësoj operim të sigurt si të rrjetit transmetues ashtu edhe të gjeneratorëve të kyçur.

Ndërtimi i stacioneve gjeneruese në fjalë planifikohet të filloj në vitin 2021, ndërsa gjenerimi i megavatëve të parë në fund të vitit 2024.



Ekipi i KFOR për Monitorim dhe Ndërlidhje vizitoi KOSTT

Menaxhmenti i lartë i KOSTT në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z.Mustafë Hasani, priten në takim Ekipin e KFOR për Monitorim dhe Ndërlidhje, në krye me Parker Mooney, Komandant rajonal qendër.

Në kuadër të bashkëpunimit ndër-institucional, përfaqësuesit nga KFOR u informuan nga afër në lidhje me implementimin e Marrëveshjes së Kyçjes

KOSTT/ENTSO-E, operimin e KOSTT si zonë rregulluese në kuadër të Bllikut AK si dhe funksionimin dhe sfidat aktuale të operimit të Sistemit të Transmetimit.

Ekipi i KFOR gjithashtu vizituan edhe Qendrën Nacionale Dispeçerike në KOSTT prej nga operohet, monitorohet dhe komandohet Sistemi i Transmetimit të energjisë elektrike të Republikës së Kosovës.



KOSTT përmbyll vitin 2020 me suksese historike për kompaninë dhe gjithë sektorin e energjisë së Republikës së Kosovës

Oператорi i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike të Kosovës, ka përmbyllur vitin 2020 me suksese të jashtëzakonshme të cilat janë arritur falë angazhimit dhe përkushtimit shumëvjeçar. Këto suksese përbëjnë arritje historike jo vetëm për kompaninë por edhe për gjithë sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës.



- Pas një procesi të gjatë disa vjeçar Marrëveshja e re e Kyçjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E, hyri në fuqi më 14 Dhjetor 2020. Me këtë, më në fund u bë realitet operimi i pavarur i KOSTT si zonë rregulluese në kuadër të Bllokut Rregullues Shqipëri-Kosovë
- Pas më shumë se katër vite që nga përfundimi i ndërtimit të linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri në të dy anët e kufirit, më 14 Dhjetor 2020 përfundimisht linja e njohur si "Autostrada Energjetike Kosovë-Shqipëri" komercialisht u vu në funksion. Vënia në operim e linjës interkonektive të tensionit të lartë 400kV Kosovë-Shqipëri ka impakt pozitiv në optimizimin e dy sistemeve, rritjen e kapaciteteve transmetuese, rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së sistemeve elektroenergjetike të Kosovës, Shqipërisë dhe regionit si dhe ndikon në zhvillimin e tregut të të dy vendeve si dhe tregut rajonal të energjisë elektrike.

- Themelimi i Bursës Shqiptare e Energjisë shënon një standard të ri të operimit në sektorin e energjisë. Një institucion i rëndësishëm për zhvillimin e tregut konkurrues të energjisë elektrike për të dyja vendet Kosovë dhe Shqipëri, përmes së cilit do të sigurohet transparencë, konkurrencë në treg dhe shfrytëzim efikas i kapaciteteve interkonektive, në përputhje me politikat shtetërore të të dyja vendeve, legjislacionin evropian dhe obligimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë.

Në përmbyllje të suksesshme të vitit 2020, Kryesuesi i Bordit të Drejtoreve z. Jeton Mehmeti theksoi "viti 2020 ka qenë vit i shkëlqyeshëm për sa i përket arritjes së synimeve të KOSTT, kemi shumë projekte të radhitura për vitin e ardhshëm dhe jam i sigurt se me përkushtimin dhe vendosmërinë e të gjithëve do t'i përmbyllim objektivat e ardhshme strategjike me kohë dhe me suksese".

Me këtë rast, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z Mustafë Hasani theksoi "Po lëmë mbrapa një vit të brishtë dhe të vështirë në aspektin shëndetësor, por një vit shumë të suksesshëm në rrafshin profesional të kurorëzuar me shumë suksese, me dëshirën që kjo të jetë një pikënjësi me fillim i ri për një rrugëtim të gjatë në zhvillim të mëtutjeshëm të kompanisë".

Në përmbyllje të suksesshme të vitit 2020 u ndanë mirënjohje për punonjësit e angazhuar në procesin e fillimit të implementimit të Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT/ENTSO-E dhe fillimin e operimit të KOSTT si zonë e pavarur rregulluese në kuadër të Bllokut Rregullues Shqipëri-Kosovë.



Me realizimin adekuat të Planit vjetor të Mirëmbajtjes u sigurua shkallë e lartë e disponueshmërisë dhe besueshmërisë së Rrjetit të Transmetimit të Kosovës

Në kuadër të fokusit të menaxhmentit për sigurimin e mbarëvajtjes së procesit të mirëmbajtjes dhe të operimit të sigurt dhe të besueshëm të Sistemit të Transmetimit, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani i shoqëruar nga Drejtori i Departamentit të Transmisionit z.Besim Gérxhaliu dhe Menaxheri i mirëmbajtjes së linjave z.Shaban Neziri me 05 Janar 2021 realizuan një vizitë në Nënstacionin 400/220 kV Kosova B ku u takuan me ekipet profesionale të mirëmbajtjes së linjave dhe ekipet e mirëmbajtjes së nënstacioneve të KOSTT.

Në ambientet e Nënstacionit Kosova B që është një nga nënstacionet më të rëndësishme të Sistemit të Transmetimit të Kosovës, menaxhmenti i KOSTT u njohtën nga afër me ecurinë dhe rezultatet e punës në kuadër të Planit vjetor të mirëmbajtjes së aseteve të rrjetit transmetues si dhe me sfidat me të cilat përballen ekipet e mirëmbajtjes gjatë punës.

"Besueshmëria dhe siguria e sistemit të transmetimit varet nga gjendja teknike e stabilimenteve andaj u jam mirënjohës përkushtimin, vullnetin dhe profesionalizmin e



dëshmuar në mirëmbajtjen e rrjetit të transmetimit gjë e cila ka reflektuar në performancën e sistemit të transmetimit në vazhdimësi" theksoi me këtë rast Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani.

Përkundër sfidave nga natyra e ndjeshme e punës si dhe ballafaqimit me pandeminë nga COVID 19, është siguruar shkallë e lartë e disponueshmërisë dhe besueshmërisë së rrjetit të transmetimit gjithnjë në funksion të përmbrushjes së objektivës për sigurinë e furnizimit cilësor me energji elektrike, nga aspekti i transmetimit.



Koordinimi dhe bashkëpunimi në mes të institucioneve, thelbësore për funksionimin dhe përparimin e sektorit të energjisë

Pas fillimit të operimit të pavarur të KOSTT si zonë rregulluese në kuadër të Bllokut rregullues Shqipëri-Kosovë, zona sinkrone e Evropës Kontinentale të ENTSO-E, si dhe jetësimit të Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT/ENTSO-E, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Mustafë Hasani me bashkëpunëtor, takoi udhëheqësit e Zyrës së Rregulatorit të Energjisë në Kosovë (ZRrE) në krye me u.d të Kryesuesit të Bordit z.Izet Rushiti, Korporatës Energetike të Kosovës (KEK) në krye me u.d.Kryeshefin Ekzekutiv z.Luigj Imeri, Kompanisë Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike (KEDS)

Ndarja e Mirënjohjes për ZRRE



Ndarja e Mirënjohjes për KEK



Ndarja e Mirënjohjeve për KEDS/KESCO



dhe Kompanisë Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z.Alper Erbas.

Në kuadër të takimeve të zhvilluara, z.Hasani ndau mirënjohje për ZRrE, KEK, KEDS dhe KESCO, në shenjë falënderimi për mbështetjen e vazdueshme në këto procese të rëndësishë primare për të ardhmen e sektorit të energjisë në Kosovë dhe KOSTT-in në veçanti.

“Koordinimi dhe bashkëpunimi i qëndrueshëm që mbizotëron në mes të institucioneve tona, si hallka të domosdoshme në zingjirin e sigurisë së furnizimit





dhe funksionimit të sektorit të energjisë elektrike, edhe një herë u dëshmuani të jenë elemente thelbësore në përparimin e mëtutjeshëm të sektorit. U jam shumë falënderues për përkrahjen tuaj për KOSTT gjatë këtyre proceseve të rëndësishme dhe besoj në bashkëpunimin e mëtutjeshëm në mes të insitucioneve tonë, gjithnjë në mbështetje të zhvillimit të sektorit që ne përfaqësojmë i cili përbën një sektor të rëndësishëm në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit", theksoi z. Mustafë Hasani, Kryeshef Ekzekutiv i KOSTT.

Vlerësohet i suksesshëm operimi i Bllokut Rregullues të Sistemeve Energjetike Kosovë-Shqipëri (Blloku AK)

Në takimin e përbashkët i cili u mbajt me datë 29 janar 2021 në Tiranë në mes të delegacioneve të nivelit të lartë të KOSTT dhe OST Shqipëri u vlerësua lartë bashkëpunimi ndërinstitucional dhe puna profesionale e ekipeve homologe që rezultuan me operimin e suksesshëm të Bllokut rregullues të sistemeve energjetike Shqipëri-Kosovë (Blloku AK).

Kryesuesi i Bordit të drejtoreve të KOSTT z. Jeton Mehmeti dhe Kryeshef Ekzekutiv i KOSTT z. Mustafë Hasani shprehën falënderimin e tyre për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm dhe përkrahjen e vazhdueshme që ka ofruar Operatori i Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë në rrugëtimin e gjatë drejt pavarësimit energjetik të Kosovës dhe fillimit të operimit të pavarur të KOSTT në kuadër të Bllokut AK, zona sinkrone e Evropës Kontinentale të ENTSO-E.

Me këtë rast gjithashtu u ndanë mirënjohje për Administratorin e OST z. Skerdi Drenova dhe ekipin profesional të OST për mbështetjen e pakursyer të KOSTT në implementimin e Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT/ENTSO-E dhe fillimin e operimit të pavarur të Sistemit të Transmetimit të Kosovës si zonë rregulluese në kuadër të Bllokut AK.

Tutje në kuadër të takimit të punës i cili u zhvillua në mes të dy kompanive homologe, u diskutua për

mundësitë e ardhshme të bashkëpunimit si dhe për hapat e radhës në drejtim të zhvillimit të mëtutjeshëm të tregut të energjisë elektrike Kosovë-Shqipëri dhe integrimit të mëtutjeshëm në tregun rajonal dhe ate panevropian të energjisë elektrike.



Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT priti në takim Dekanin e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të Universitetit "Hasan Prishtina"

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Mustafë Hasani me bashkëpunëtorë, më 11 Dhjetor 2020 priti në takim dekanin e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK) të Universitetit "Hasan Prishtina" prof. asoc. Dr. Isak Shabani, me bashkëpunëtorë.

Në kuadër të takimit, u diskutua rreth bashkëpunimit të fryshtës në mes të dy institucioneve me ç'rast z.Hasani shprehi gatishmërinë e tij për avansimin e bashkëpunimit të gjertanishtës me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve profesionale të tij rinjëve, kuadër i cili do të shërbejë në të mirë të zhvillimit të sektorit të energjisë në Kosovë, në të ardhmen.



Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar në mes të KOSTT dhe FIEK përndarjen e 10 bursave për vitin akademik 2020/2021, gjithashtu u nënshkruan kontratat me studentët përfitues të bursës.

Kontributi në mirëqenien e komunitetit, përkushtim i vazhdueshëm i KOSTT sh.a

Viti 2020 e sfidoi njerëzimin në mënyra të ndryshme, duke e ndryshuar sjelljen njerëzore po ashtu edhe atë të bizneseve dhe si kurrë më parë edhe më shumë u shpreh rritja e vetëdijes kolektive për kujdesin ndaj shëndetit, mirëqenies dhe përgjegjësisë ndaj komunitetit.

Përkundër të gjitha sfidave të paraqitura për shkak të pandemisë COVID 19, KOSTT arriti ta përmbylli vitin me sukses të theksuara, duke mos lënë anash asnjëherë përkushtimin për të kontribuar në mirëqenien e shoqërisë dhe në mbështetje të këtij misioni, së fundi KOSTT realizoi mbështetje për:

- *Shoqatën Down Syndrome Kosova #DSK për mbulimin e nga 25 seancave terapeutike për fëmijët me sindromën Down në të katër qendrat e shoqatës (Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Ferizaj)*
- *Action for Mothers and Children /Aksioni për Nëna dhe Fëmijë #AMC – për pajisje personale mbrojtëse nga COVID 19 për shëndetin e punëtorëve shëndetësorë, nënave dhe fëmijëve për Klinikat e Gjinekologjisë dhe Neonatologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës sidhe*



- *SHGPLKKGJ – #RENESANSA për të kontribuar përgjitjen e vetëdijes së grave për zbulimin e hershëm dhe trajtimin e kancerit të gjirit*

Me këtë rast, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Mustafë Hasani u shpreh "Filozofia jonë e veprimit të përgjegjshëm në të gjitha aspektet e veprimtarisë është esenciale për suksesin e kompanisë dhe kjo qasje shkon edhe më tutje duke ndërmarrë veprime të vazhdueshme për të ndikuar sado pak në mirëqenien e shoqërisë sonë".

#NeJemiKOSTT

Përkushtimi dhe kontributi i secilit punonjës pa dallim është vlerë e çmuar në drejtim të përmbushjes së objektivave strategjike të kompanisë. Në kuadër të serisë së intervistave #NeJemiKOSTT këtë radhë ju prezentojmë.



Edita Bytyqi-Muqurtaj është Magjistre e Shkencave të Elektroenergetikës dhe nga Shkurti i vitit 2011 Edita punon në KOSTT si Inxhinier për Planifikimin e Mirëmbajtjes Afatgjatenë kuadër të Departamentit të Operatorit të Transmisionit. "Derisa mendoj që perspektiva e së ardhmes është energjia dhe sidomos energjia eficiente, zhvillimet teknologjike dhe sfidat në sektorin e energjisë më inspirojnë të merrem me këtë profesion me pasion dhe zell të madh. Në përvojën time 10 vjeçare në KOSTT nuk kam hasur në nënverësimë profesionale gjinore dhe mendoj që të dy gjinitë pa dallim vlerësohen njësoj." u shpreh Edita.

EDITA BYTYQI MUQURTAJ

Inxhinier për planifikimin e mirëmbajtjes afotgjate

Kushtrim Krasniqi është inxhinier i diplomuar i elektroteknikës dhe punon si Dispeçer Operativ Nacional që nga viti 2011 në Departmentin e Operimit të Sistemit në KOSTT. "Në përgjithësi, puna në sektorin e energjisë është shumë sfiduese, por edhe relaksuese pas sukseseve që arrin në punë apo projekte të caktuara. Kjo tashmë është dëshmuar viteve të fundit që gjinia femërore është shumë e angazhuar dhe rezultatet janë të dukshme, e diversiteti gjinor do të jep çdo herë e më shumë kontributin në sektorin e energjisë." u shpreh Kushtirimi.



KUSHTRIM KRASNIQI

Dispeçer Operativ Nacional



Krenare Osman Gjukaj përfundoi studimet dhe masterin në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti Ekonomic, drejtimi Ekonomiks. Në Shkurt të vitit 2011 u punësua në KOSTT dhe nga viti 2018 mban pozitën Menaxhere e Sektorit të Tarifave në kuadër të Departamentit për Çështje Rregullative dhe Tarifa. "Puna në sektorin e energjisë është shumë atraktive dhe sfiduese njëkohësisht. Puna të cilën e bëj është një ndërlidhje e fushave të inxhinierisë dhe ekonomisë, andaj ndjehem me fat dhe e privilegjuar që të punoj në një kompani të tillë siç është KOSTT. Ndjehem me fat që punoj në një kompani ku çmohem për punën profesionale pa dallime gjinore, duke më ofruar kushte dhe mundësi të avancohem profesionalisht." u shpreh ajo.

KRENARE OSMANI GJUKAJ

Menaxhere e Sektorit të Tarifave

#NeJemiKOSTT



Etor Tahirri është inxhinier i elektroteknikës i diplomuar në drejtimin "Sistemet Elektroenergetike" në Fakultetin Elektroteknik në Universitetin e Prishtinës. Në vitin 2011 u punësua në KOSTT dhe nga viti 2018 ai mban pozitën Menaxher i Sektorit për Ndërtim të Rrjetit,. "Puna në sektorin e energjisë gjithmonë ka qenë atraktive sidomos kur je drejtëpërdrejtë i lidhur me projekte të ndryshme elektro-energetike. Gjatë karrierës time kam qenë i kyçur në më shumë se 20 projekte të ndryshme të cilat i ka zhvilluar kompania jonë KOSTT. Mendoj që ne si KOSTT jemi në rrugë të mirë për të arritur kuotat e diversitetit gjinor dhe KOSTT tashmë është pjesë e një programi të tillë dhe shpresojmë që së shpejti do kalojmë edhe këtë sfidë që e kemi përparrë si shoqëri!."

ETOR TAHIRI

Menaxher i Sektorit për Konstruktim
të Rrjetit

Herolinda Blakaj Lekaj ka përfunduar studimet në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës dhe është Master i Shkencave të Inxhinierisë Elektrike. Herolinda punon si Inxhiniere për Operim të Tregut që nga viti 2016 në Departamentin e Operimit të Tregut në KOSTT. "Energjia Elektrike përdoret nga të gjithë! Ekonomia dhe çdo sektor tjeter mbështeten në të pasurit energji elektrike të qëndrueshme, dhe duke qenë pjesë e kësaj industrie përkatësisht pjesë e KOSTT automatikisht je pjesë e diçkaje të madhe. Ndonëse sektori i energjisë ka qenë tradicionalisht i dominuar nga meshkujt, kjo ka filluar të ndryshojë dhe mendoj se KOSTT është kompania shembull e fillimit të këtij ndryshimi në Kosovë" shprehet Herolinda.

**HEROLINDA BLAKAJ**

Inxhinere për Operim të Tregut



Sylë Bytyqi është inxhinier i diplomuar i elektroteknikës në drejtimin "Automatikë Elektronike" në Fakultetin e Elektroteknikës në Universitetin e Prishtinës. Aktualisht Syla mban titullin Senior Inxhinier Specialist për SCADA SCS në KOSTT. "Sistemet SCADA janë bashkësi integrale e një mori pajisjeve me rol dhe funksion të veçantë, prandaj mbajtja e tyre në gjendje të rregullt të funksionimit dhe komunikimit me njëra tjetrën, nganjëherë zëvendësimi i tyre apo zgjerimi me pajisje dhe teknologji tjeter është mjaft sfiduese. Diversiteti dhe gjithëpërfshirja janë kushte për një shoqëri të drejtë dhe të zhvilluar nga pikëpamja sociale dhe ekonomike të cilat duhet të merren parasysh në punën e secilit institucion." u shpreh Syla.

SYLË BYTYQI

Senior Inxhinier Specialist për SCADA SCS

#NeJemiKOSTT

**LENDITA MYDERRIZI***Menaxhere e Objekteve*

Lendita Myderrizi përfundoi studimet në Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës, drejtimi i Arkitekturës dhe Ndërtimtarisë, në vitin 1986. Detyrën si Menaxhere e Objekteve në KOSTT e ka filluar nga viti 2007. "Rruja ime drejt sektorit të energjisë është e ndërlidhur ngushtë me pasionin dhe profesionin tim të arkitekturës. Si çdo proces tjetër, transmisioni i energjisë elektrike në prapavijë kërkon edhe shumë inpute dhe parakushte tjera që e mundësojnë këtë shërbim, përfshirë këtu hapësirat dhe konstruktionet adekuate mundësimin e një ambienti të duhur pune për personelin Rritja e pjesëmarrjes së gruas në tregun e punës në Kosovë është gjithsesi e nevojshme për shumicën e sektorëve, por sidomos për fushat ku ekzistojnë paragjykime gjinore, siç është energjia apo ndërtimtaria" u shpreh Lendita.

Lulzim Shahini përfundoi studimet në lëmin e ekonomisë dhe mban titullin Master në Menaxhment dhe Informatikë dhe aktualisht mban pozitën Specialist për analizë dhe planifikim të burimeve njerëzore. "Duke konsideruar rëndësinë e sektorit të energjisë në zhvillimin e ekonomisë së vendit tonë e në veçanti rolin që mban KOSTT në këtë drejtim, zhvillimi i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike që nga themelimi e deri me sot, të bënë që të ndjehesh mirë që je pjesë e kësaj familje. Pa dyshim që kontributi i të dy gjinive është i rëndësishëm në sektorin e energjisë e me këtë edhe në KOSTT, duke kontribuuar në rritjen e diversitetit gjinor.".



Për të lexuar intervistat e plota ju lutemi të vizitonit faqen zyrtare të KOSTT, www.kostt.com

LULZIM SHAHINI*Specialist për analizë dhe planifikim të burimeve njerëzore*

Buletini nr.18, Viti XIV, 2021
 Rr. Isa Boletini, Nr. 39, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
 Tel: +383(0) 38 501 301 174; email: info@kostt.com
 Web: www.kostt.com

Buletini është publikim periodik i KOSTT sh.a i cili përgatitet nga Zyra për Komunikim dhe Relacione me Publikun
 Për më shumë informacione ju lutemi kontaktoni në:
zana.rama@kostt.com ose info@kostt.com
 Publikuar në mars 2021

